

VENDIM
Nr. 65, datë 8.2.2023

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI I AKSEVE RRUGORE ‘UNAZA LINDORE, LOTI
II’ DHE PROBLEMATIKAT E RRUGËVE DYTËSORE TË OBJEKTIT”**

(Ndryshuar me VKM nr. 66, datë 14.2.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i akseve rrugore ‘Unaza Lindore, loti II’ dhe problematikat e rrugëve dytësore të objektit”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, “arë” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 52 861 542.3 (pesëdhjetë e dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e dy mijë pikë tre) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 52 861 542.3 (pesëdhjetë e dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e dy mijë pikë tre) lekësh, përballohet, si më poshtë vijon:

a) vlera prej 51 783 837.3 (pesëdhjetë e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë pikë tre) lekësh, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar;

b) vlera prej 1 077 705 (një milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e pesë) lekësh, nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1 pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuar.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI I

AKSEVE RRUGORE "UNAZA LINDORE LOTI II" DHE PROBLEMATIKAT E
RRUGËVE DYTËSORE TË OBJEKTIT”.

N. r.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas zvrpp)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË										Konfir mimet	SHËNIM E	Adresa
	Emri	Adre sia	Mbi emri	Z K	Nr. pas	Lloji .pas	Sip.Tota le(m2)	Shpronësim tokë "are"			Shpronësim tokë "truall"			Ndërtesë banimi (shitëpi)			VLE RA			
								Si p. (m 2)	Çmi mi (lekë /m2)	Vler a (lek ë)	Sip. (m2)	Çmi mi (lekë /m2)	Vle ra (lek ë)	Sip.N dërl. konf.	Çmimi mes. sh/ble rjeve	Vlera (lekë)	TOT ALE			
																	ZVR PP sipas zvrpp			
																	(m2)			
																	(l/m2)			
1	Syrja	Hyse n	Sula	39 76	234/ 124	Truall + nderies	300			0	120	479	574 80	326.2	61167	19952 675.4	20010 155.4	Konfir muar nga Ashk		Tirane, Shkoze rruga Nikollë Mekaj s hi
2	Gez m	Sela mi	Colla ku	39 76	233/ 142	Arc+truall +Nderies	383	17 4	448	7795 2	151	479	723 29	257.4	61167	15744 385.8	15894 666.8	Konfir muar nga Ashk		Tirane, Shkoze
3	Skënd er Lalzi m	Isla m Isla m	Isalla Isalla	39 76	234/ 107	Truall+ nderies	300			0	225	479	107 775	236.3	61167	14453 762.1	14561 537.1	Konfir muar nga Ashk		Tirane, Shkoze
4	Muhar em	Kale m	Lala	39 76	233/ 229	Arc	1278	28 2	448	1263 36			0				12633 6	Konfir muar nga Ashk		Tirane, Shkoze
5	Ahaz	Ahas h	Rrah mani	39 76	234/ 27	arc	498	95	448	4256 0			0				42560	Konfir muar nga Ashk		Tirane, Shkoze
6	Sefer	Ram azan	Cing a	39 76	236/ 28	truall	500			0	26	479	124 54				12454	Konfir muar nga Ashk		Tirane, Shkoze
	Anila	Sefer	Hox ha																	
	Saimir	Sefer	Cing a																	
	Engjel huse	Sefer	Shkal la																	
7	Hasan	Musa	Qord ja	35 50	170/ 2	arc	10060	22 99	448	1029 952			0				10299 52	Konfir muar nga Ashk	Ka dale ne vkm 221 date 13.4.2022p er superfagen 542 m2	Tirane, Surrel
8	Aleks	Jaho	Ymer i	39 76	170/ 74	arc	780.7	52	448	2329 6			0				23296	Konfir muar nga Ashk	Vendoset Barre Hypotekor e NGA DREJTOR IA E PERGJIT HESIME E TAKSAV E VENDOR E TIRANE SHKRES NR 123403 PROT DT.04.8.20 16 ZVRPP NR.26/64. DT. 08.08.2016	Tirane
9	Andre a	Hyse n	Sula	39 76	234/ 117	arc	280	15 1	448	6764 8			0				67648	Konfir muar nga Ashk		Tirane, Ruga Idriz Dollaku
10	Andre a	Çaus h	Shuli	39 76	170/ 51	arc	370	34	448	1523 2			0				15232	Konfir muar nga Ashk	MBI KETE PASURI POZICIO NOHET 170/51- ND VOL 19FQ121 L LEG	Tirane, Ruga Kostand in Shpatar aku
Vlera Totale																		51783 837.3		

LISTA SHITESË E PRONARËVE, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË
SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTTI “RIKUALIFIKIMI I
AKSEVE RRUGORE ‘UNAZA LINDORE, LOTI II’ DHE PROBLEMATIKAT E RRUGËVE DYTËSORE
TË OBJEKTTI”

N r.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (sipas kartelës së pasurisë)				TË DHËNAT PËR SHPRONËSIM										Konfir mimet	SHËNIM E	Adresa
	Em ri	Atësi ia	Mbiemri	Z K	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip - totale (m ²)	Shpronësim tokë "arë"			Shpronësim tokë "tërall"		Çmimi (lekë/ m ²)	Vlera (lekë)	Objekt social- ekonomik		VLER RA TOT ALE (lekë)			
								Sip - (m ²)	Çmimi (lekë/ m ²)	Vlera (lekë)	Sip. (m2)				Sip. e ndërt esës	Vlera e preven titiv				
1 1	Besnik	Haxhi	Balla	16 04	45/13	tërall	500				107	5140	549 980				54998 0	Konfirmuar nga ASHK-ja	Shënim. Seksioni E "Godinë banimi 2kat + 1 kat nën tokë + 109.5m ² kati përditë = 108.1m ² sip verande=30.1 sip kat i parë 108.1m ² sip verande 36.5 sip papafingo=8 0.5m ² sip.verande= 19.5m ² sip.katit përditë objekt ndihmës=35 .3m ² ". Objekti i banimit sipas dokumentacionit të lëshuar nga ASHK-ja nuk preket nga shpronësimi.	Tiranë, Shkozë
1 2	Nazif	Tahir	Hate	39 76	236/1 93	tërall	20				6	479	287 4	15.2	432973 .98	43584 8	Konfirmuar nga ASHK-ja		Tiranë, Shkozë	
	Tahir	Nazif	Hate																	
1 3	Artur	Novruz	Hyseinaj	39 76	234/2 4	tërall	450				59	479	282 61			28261	Konfirmuar nga ASHK-ja		Tiranë, Shkozë	
	Ajet	Novruz	Hyseinaj																	
1 4	Halim	Tahir	Hate	39 76	236/1 3	arë	600	25	448	112 00						11200	Konfirmuar nga ASHK-ja		Tiranë, Shkozë	
1 5	Besnik	Haxhi	Balla	16 04	45/11	arë	930	11 7	448	524 16						52416	Konfirmuar nga ASHK-ja		Tiranë, Surrel	
Vlera totale																	10777 05			

